




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidatët pjesëmarrës për aplikim për licencë të KPM-së, në bazë të konkursit të shpallur më 27 shtator 2019, për Komunën e Prishtinës:

Kandidati: N.SH. "Infokusi"
Nr. unik identifikues: 810202292
Pronar: znj. Valdete DAKAJ
Emri i propozuar: Radio Focus
Adresa: Rr/Beqir Kastrati, Ob.2 Nr. 29
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R1

Kandidati: "Klan Kosova" SH.P.K.
Nr. unik identifikues: 810795297
Përfaqësuar nga: z. Gazmend SYLA
Emri i propozuar: Klan Radio 1
Adresa: Zona Industriale
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R2

Kandidati: "Radio X" SH.P.K.
Nr. unik identifikues: 811363051
Pronar: Astrit DUHSI
Emri i propozuar: Radio X
Adresa: Rr/ Ismail Dumoshi, Nr. 20
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R3

Kandidati: "Inntegra" L.L.C.
Nr. unik identifikues: 810875495
Pronar: z. Menduh LLUKA
Emri i propozuar: Radio Club FM
Adresa: Rr/ Isa Kastrati, Nr. 1
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R4

Kandidati: "Universiteti AAB" SH.P.K.
Nr. unik identifikues : 810478299
Përfaqësuar nga: Gëzim SHABANI
Emri i propozuar: Radio AAB
Adresa: Zona Industriale
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R5

Kandidati: "Paper Communications" SH.P.K.
Nr. unik identifikues : 810795809
Pronar: z. Ilir GRAPCI
Emri i propozuar: Radio Classic FM
Adresa: Perandori Justinian, sol 1/6
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R6

Kandidati: "Tau- Gen – Injiniering SH.P.K.
Nr. unik identifikues : 810536
Pronar: Ilaz Çollaku
Emri i propozuar: Radio FAKTI

Adresa: Varosh
Lipjan
Kodi i kandidatit: R7

Ref: 1912/1432/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e kandidatit R4, R5 dhe R6 për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë regjionale në Komunën e Prishtinës

Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuara të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6, i Ligjit për KPM-në, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, më 27 shtator 2019, KPM-ja ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim regjional të radio programeve në Komunën e Prishtinës. Konkursi ka qenë i hapur nga data 27 shtator 2019 deri më datën 27 tetor 2019, ora 16:00, ndërsa më datën 25 tetor 2019, KPM-ja ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të konkursit deri më datën 8 nëntor 2019, ora 16:00.
5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë:
 - Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02);
 - Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02); dhe
 - Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
6. Kandidatët R4, R5 dhe R6 kanë dorëzuar aplikacionet e kompletuar në KPM, në pajtim me konkursin publik. Ndërsa, kandidatët R1, R2, R3 dhe R7 kanë dorëzuar aplikacionet brenda afatit për aplikim, mirëpo jo të kompletuara në KPM, në pajtim me konkursin publik.

